



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:200276
Datë: 12.03.2024
Numri i dokumentit: 05440422

Ac.nr.3816/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, kundër të paditurit A.K, për rimbursim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë C.nr.382/17 i datës 06/04/2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 12/03/2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, dhe VËRTETOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë C.nr.382/17 i datës 06/04/2021.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin ankimor C.nr.382/17 i datës 06/04/2021, ka vendosur më sa vijon:

I.REFUZOHET kërkesë-padia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, , përmes së cilës ka kërkuar që të “detyrohet i padituri A.K që paditësit Byrosë Kosovare të Sigurimit t’i rimbursoj shumën prej 1,588.00 -€, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 06.11.2013 në Suharekë dhe atë me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga dita e ngritjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare, si dhe t’i paguaj shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm” si tërësisht e PABAZUAR, për shkak të parashkrimit.

II. OBLIGOHET paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit, që të paditurit A.K, t’ia paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 239.00 euro, të gjitha këto në afat prej 15, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim

që të aprovoj ankesën e paditëses ndërsa aktgjykimin e atakuar të ndryshoj dhe të aprovoj kërkesëpadinë.

I padituri ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja Byroja Kosovare e Sigurimeve, pranë gjykatës së shkallës së parë, me datë 26/10/2017, ka paraqitur padi, kundër të paditurit, për rimbursim dëmi, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar. Paditësja në shqyrtimin kryesor dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë me propozim që gjykata të detyroj të paditurin të bëjë rimbursimin e dëmit, ngase nuk kemi parashkrim të kërkesëpadisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se nuk ishte kontestuse gjendja faktike se me datën 06/11/2013, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit dhe paditësja ka lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore me të dëmtuarin E.J, për kompensimin e dëmit në shumë të përgjithshme prej 1588,00 euro, e të cilën pagesë e ka përmbushur me datën 18/02/2014, ndërsa padinë e ka paraqitur me datën 26/10/2017 apo pasi ka kaluar afati ligjor prej 3 viteve. Mbi këto arsye ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 357 par.1, të LMD-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK, dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala e paditur me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë, sepse në bazë të provave të

administruara, nuk ishte kontestuese fakti se me datën 06/11/2013, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit dhe paditësja ka lidhur marrëveshje jashtëgjyqësore me të dëmtuarin, për kompensimin e dëmit në shumë të përgjithshme prej 1588,00 euro, e të cilën pagesë e ka përmbushur me datën 18/02/2014 dhe kjo vërtetohet nga urdhër pagesa, ndërsa padinë e ka paraqitur me datën 26/10/2017. Sipas nenit 362 par.3 të LMD-së, e cila dispozitë ligjore parasheh: *Kërkesat e siguruesit nga kontratat e sigurimit parashkruhen për tre (3) vjet, ndërsa paragrafi 4 i po këtij neni ka paraparë: Nëse i dëmtuari në rastin e sigurimit nga përgjegjësia kërkon shpërblim nga i siguruari, ose shpërblimin e ka marrë prej tij, parashkrimi i kërkesës të të siguruarit ndaj siguruesit fillon që nga dita kur personi i dëmtuar ka kërkuar në rrugë gjyqësore shpërblimin nga i siguruari, respektivisht kur i siguruari t'ia ketë shpërblyer dëmin.* Në këtë rast afati i parashkrimit për kërkesat e siguruesit është 3 vjet, por vetëm dallon momenti i fillimit të afatit të parashkrimit nga data kur siguruesi ia ka shpërblyer dëmin palës së dëmtuar. Andaj, Gjykata e Apelit duke u bazuar në nenin 362 par.3 dhe 4 të LMD-së ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar, ngase padia është ushtruar pas kalimit të afatit ligjor prej 3 viteve.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195 par.1 pika d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.3816/21, me datë 12/03/2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku